



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

714, 718, 720, 721/20

Nr/Br.

Datë/Datum.

29.10.20

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE

PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 714/20  
718/20  
720/20  
721/20

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: Blerim Dina - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatorët ekonomik “Oltitrasing” SH.P.K-Prishtinë, grupi i operatorëve ekonomik “Edona” SH.P.K, “Company Murseli” SH.P.K, “Suvatimi” SH.P.K”, grupi i operatorëve ekonomik “AC Ing” SH.P.K-, OE: “A Con”SH.P.K-, dhe OE “BM Grup” SH.P.K, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku janë rekomanduar për kontratë OE: GOE “Globi-M.I” SH.P.K dhe OE: N.N.P “Euro Construction”-, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i ri i stacionit të autobusëve” me nr. të prokurimit: 651-20-2311-5-1-1 , iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) -“KK-Gjilan”(KK-GJ), më datën: 28.10.2020, mori këtë:

## V E N D I M

**I. APROVOHEN**, pjesërisht si të bazuara ankesat e operatorëve ekonomik “Oltitrasing” SH.P.K- Prishtinë, grupi i operatorëve ekonomik “Edona” SH.P.K, “Company Murseli” SH.P.K, “Suvatimi” SH.P.K”, grupi i operatorëve ekonomik “AC Ing” SH.P.K-, OE: “A Con”SH.P.K-, dhe OE “BM Grup” SH.P.K., kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i ri i stacionit të autobusëve” me nr. të prokurimit: 651-20-2311-5-1-1 , iniciuar nga Autoriteti Kontraktues KK-Gjilan

**II. ANULOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i ri i stacionit të autobusëve” me nr. të prokurimit: 651-20-2311-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) -“KK-Gjilan”(KK-GJ), dhe lënda të kthehet në **Rivlerësim**.

**III.** Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konfirmon dispozitat ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik OE “Oltitrasing” SH.P.K- Prishtinë, grupi i operatorëve ekonomik “Edona” SH.P.K, “Company Murseli” SH.P.K, “Suvatimi” SH.P.K”, grupi i operatorëve ekonomik “AC Ing” SH.P.K-, OE: “A Con”SH.P.K-, dhe OE “BM Grup” SH.P.K, aprovohen pjesërisht si të bazuara, i’u bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## AR SY ET IM

Operatorët ekonomik ankues “Oltitrasing” SH.P.K- Prishtinë, grupi i operatorëve ekonomik “Edona” SH.P.K, “Company Murseli” SH.P.K, “Suvatimi” SH.P.K”, grupi i operatorëve ekonomik “AC Ing” SH.P.K-, OE: “A Con”SH.P.K-, dhe OE “BM Grup” SH.P.K, si palë të pa kënaqura kanë deponuar ankesë në OSHP, me 26.09.2020 me nr. 714/20, me 25.09.2020 me nr. 714/20, me datë 24.09.2020 me nr. 720/20 dhe me datë 25.09.2020 me nr. 721/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku janë rekomanduar për kontratë OE “Globi-M.I” SH.P.K dhe OE N.N.P “Euro Construction”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i ri i stacionit të autobusëve” me nr. të prokurimit: 651-20-2311-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) “KK-Gjilan”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 7, 9.1 dhe 9.2, 59 të LPP-së, si dhe nenet 40 paragrafi. 40.13, 41 të RRUOPP-së të ankesa me nr.714/20.
- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 7, 59, 60, si nenin 72 të LPP-së të ankesa me nr. 718/20.
- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin:1, 6, 7, 59, 60, 64, 69, 72, si dhe nenin 108/A të LPP-së të ankesa me nr.720/20.
- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin:1, 6, 7, 59, 69, si dhe neni 72 i LPP-së të ankesa me nr.721/20.

Organi Shqyrtues i Prokurimit konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 06.10.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 16.10.2020, lidhur me pretendimet ankimore të OE ankues i sqarojnë si në vijim:

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “Oltitrasing” SH.P.K- Prishtinë, OE: GOE “Edona” SH.P.K-, OE: “Company Murseli” SH.P.K- , OE : “Suvatimi” SH.P.K – ,OE: GOE “AC Ing” SH.P.K-, OE: “A Con”SH.P.K-,dhe OE: “BM Grup” SH.P.K,

Përgjigje në Pretendimin ankimor të OE “Oltitrasing” SH.P.K

Përgjigje në Pretendimin ankimor nr. 1

OE ankues pretendon qe nuk qëndron arsyeja e eliminimit nga ana e AK-së ku thotë se ju mungon validiteti i certifikatave për saldator sepse të katërt salduesit e paraqitur, certifikatat kanë validitet 3 vjeçar mirëpo duhet që për çdo vit të bëhet ri lëshimi i certifikatave, po ashtu nuk ka as kontrata pune, CV apo ndonjë referencë.

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontratë është: “Operatori ekonomike duhet të angazhoj personelin profesional te cilët duhet te kenë kualifikimet shkollore te mëposhtme..... 4 ( Katër ) saldues të certifikuar” Dhe si dëshmi dokumentare është kërkuar: “Për te gjithë personelin profesional - Për menaxherin e Projektit si dhe Personelin Kryesor Teknik, të paraqiten Diplomat përkatëse te noterizuar , kontratat e punës , CV dhe letër referencë në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësit. Një ashtu për salduesit kopja e certifikatës”

Pas analizimit t ë dokumentacionit t ë ofruar nga ana e OE ankues, eksperti shqyrtues sqaron se OE ka ofruar një listë me katër Saldues konform dosjes së tenderit dhe për këta saldues si dëshmi ka paraqitur kontrata të punës me kohë të caktuar, CV, referencë dhe Certifikatat valide të noterizuar, ndërsa sa i përket arsyes së AK-së që certifikatat duhet të ri lëshohen çdo vit, eksperti shqyrtues vlerëson se certifikatat janë valide dhe janë konform kërkesës së dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontratë andaj ky pretendim ankimor është i qëndrueshëm.

Përgjigje në pretendimet ankimore t ë GOE “Edona” SH.P.K”; “Company Murseli” SH.P.K” Suvatimi” SH.P.K;

Përgjigje në Pretendimin ankimor nr. 1

Si arsye e eliminimit nga AK është se OE nuk e ka dorëzuar listën e kontratave sipas Aneksit 6 te dosjes se tenderit. OE ankues pretendon qe kjo arsye është e pa qëndrueshme për shkak se lista e paraqitur nga ana e OE nuk dallon ne substancë nga lista të cilën e ka kërkuar AK.

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është: “Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses se paku 2 kontrata të ngjashme në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë. vlera, minimale duhet të jetë – 600 000,00 €”. Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: “Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës të bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve”. Pas analizimit të dokumentacionit të ofruar nga ana e OE ankues, eksperti shqyrtues sqaron se si dëshmi OE ankues ka paraqitur listën e projekteve të realizuar e cila nuk është e njëjtë me formën e tabelës së paraqitur në Aneksin 6 të dosjes së tenderit, por lista i përmban të dhënat lidhur me projektet e kërkuara, autoritetin kontraktues, vlerën e projektit, operatorin ekonomik si dhe vitin, po ashtu OE ka bashkëngjitur kontratat dhe referencat konform dosjes së tenderit. Andaj, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i OE ankues në këtë pik është i qëndrueshëm. Në qoftë se AK ka ndonjë paqartësi sa u përket kontratave të realizuara, referencat ose për certifikata, gjatë rivlerësimit mund të kërkoj sqarimi konform Nenit 59.2 dhe Nenit 72 të LPP-së.

#### Përgjigje në Pretendimin ankimor nr. 2

Arsyeja e dytë e eliminimit të OE në fjalë nga ana e AK-së është se GOE për menaxher të projektit ka caktuar z. Elnaim Ymeri, ku ky inxhinier ka kontratë me KK Gjilan në projektin hartimin e projekteve në infrastrukturën rrugore. OE ankues pretendon që kjo arsye nuk qëndron për faktin se nuk ka asnjë dëshmi se i njëjti inxhinier ka marr pjesë në hartimin e projekteve konkretisht për tenderin “Ndërtimi i ri stacionit të autobusëve”.

Lidhur me këtë pretendim eksperti shqyrtues me datën 08.10.2020 i ka dërguar letër AK-së përmes postës elektronike, ku ka kërkuar dëshmi lidhur me inxhinierin z. Elnaim Ymeri dhe ka kërkuar më shumë sqarime. Deri në momentin e hartimit të ekspertizës AK-ja nuk është përgjigjur postës elektronike. z. Elnaim Ymeri figuron në listën e të punësuarve të kompanisë “Edona” SH.P.K dhe në CV e tij të ofruar ka cekur që ka mbikëqyr disa projekte në Komunën e Gjilanit mirëpo për projektin në fjalë nuk ka të dhëna andaj eksperti shqyrtues vlerëson që gjatë rivlerësimit AK-ja mund të sqaroj këtë pikë konform dispozitave të LPP-së.

Në vijim mund të shihni kërkesën drejtuar AK-së nga ana e ekspertit shqyrtues.

## Pershendetje

Gjemajli Bellanica

Sent: Thu 10/8/2020 11:40 AM

To: Salih Kqiku

Jam i autorizuar ne shqyrtimin e pretendimeve ankimore per lender "Ndertimi i ri i Stacionit te autobuseve" Ju si AK ne arsyen e eliminimit per GOE "Edona" Sh.p.k"; "Company Murseli" Sh.p.k" Suvatimi" Sh.p.k;" keni then se per inxhinierin z.Elnaim Ymeri ka kontrat me KK Gjilan per projektin Hartimi i Projekteve ne infrastrukturen rrugore.Kerkoje nga ana juaj te ofroni deshmi lidhur me kete dhe kerkoj me shume sqarime.

Gjithe te mirat

Gjemajli Bellanica  
Ekspert Shqyrtues  
Organi Shqyrtues i Prokurimit  
Prishtinë

Përgjigje në Pretendimin ankimor nr. 3

Arsyeja e tretë e eliminimit të OE ankues nga ana e AK-së është se OE ankues nuk e ka dorëzuar listën e pagave për 20 (njëzetë punëtor). OE ankues pretendon që kjo arsye e eliminimit është e pa qëndrueshme për faktin se OE ka prezantuar listën e pagave për 20 punëtorë ashtu siç është kërkuar në FDT dhe kemi bashkangjitur edhe listën e pagave nga ATK-ja.

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është: "Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar min. 20 punëtor" Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: "Listën e pagave të operatorit ekonomik. Duhet të dorëzohet origjinal ose kopje e noterizuar".

Lidhur me këtë pretendim ankimor eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues si dëshmi dokumentare ka paraqitur listë të punëtorëve ndërsa në dosje të tenderit decidivisht është kërkuar listë e pagave për 20 punëtorë, andaj dëshmitë e ofruara nga OE nuk janë konform dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë ndërsa sa i përket pretendimit se OE ankues ka bashkangjitur edhe listën e ATK-së, në ofertën e OE ankues nuk kemi gjetur të bashkangjitur listë të ATK-së andaj ky pretendim ankimor në këtë pikë është i pa bazuar.

Përgjigje në pretendimet ankimore të GOE "AC Ing "SH.P.K & "A CON" SH.P.K

Përgjigje në Pretendimin ankimor nr. 1

OE ankues pretendon se arsyet e eliminimit nga AK janë të pabazuara sepse salduesve i mungojnë: Kontratat, CV dhe referencat e salduesve nuk ka qenë kërkesë e FDT-së për dorëzim.

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është: "Operatori ekonomike duhet të angazhoj personelin profesional të cilët duhet të kenë kualifikimet shkollore të mëposhtme ....4 ( Katër ) saldues të certifikuar" Dhe si dëshmi dokumentare është kërkuar: "Për të gjithë personelin profesional - Për menaxherin e Projektit si dhe Personelin Kryesor Teknik, të paraqiten

Diplomat përkatëse te noterizuar, kontratat e punës, CV dhe letër referencë në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësit. Një ashtu për salduesit kopja e certifikatës”.

Pas analizës së dosjes së tenderit të ofruar nga OE ankues, eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues nuk ka paraqitur kontratë pune, CV, referenca për saldues me arsyetimin që nuk janë kërkuar në FDT, mirëpo eksperti sqaron se edhe për saldues janë kërkuar kontrata e punës, CV, referenca, shih me lartë kërkesën dhe dëshminë e kërkuar në FDT. Andaj eksperti shqyrtues vlerëson që dëshmitë e ofruar nuk e plotësojnë tërësisht dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë, rrjedhimisht ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimin ankimor nr. 2

OE ankues pretendon që arsyeja e eliminimit Kontratat, CV dhe referencat e salduesve është e pa bazuar sepse salduesi z.Artan Dashi posedon Certifikatë me Nr: i Certifikatës është ER-414-QT Ë.

Pas analizimit të dokumentacionit të ofruar nga OE ankues, eksperti shqyrtues sqaron se ka bërë verifikimin e certifikatës të z.Artan Dashi të prezantuar me numër ER-414-QT Ë dhe rezulton që certifikata është valide dhe vlen prej 08.11.2018 deri me 07.11.2021, andaj ky pretendim ankimor është i bazuar.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE BM Grup SH.P.K

Përgjigje në Pretendimin ankimor nr. 1

OE ankues pretendon se AK e ka eliminuar me arsyetimin se nuk e ka plotësuar kërkesën numër 3 të nenin 9.1 & 9.2 të dosjes së tenderit, për skelet mbajtëse.

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është: “Operatori Ekonomik duhet të posedojë mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 7 të DT-se” Dhe si dëshmi dokumentare është kërkuar: “OE duhet të plotësojë dhe dorëzojë listën e pajisjeve duke plotësuar Aneksin 7 të Dosjes së Tenderit dhe duhet të bashkëngjis Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet që nuk regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit për automjetet që regjistrohen. Në rastet kur OE ka marrëveshje për shfrytëzimin, OE duhet të dorëzojë edhe marrëveshjen për shfrytëzim”

Pas analizimit të dokumentacionit të ofruar nga OE ankues, eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues ka paraqitur një marrëveshje për qiramarrje me OE Timo Construction SH.P.K, për plotësimin e Aneksit 7 të dosjes së tenderit, andaj eksperti shqyrtues vlerëson se ky pretendim ankimor është i bazuar, mirëpo në rast se AK-ja ka paqartësi gjatë rivlerësimit mund të kërkojë sqarime konform Nenit 59.2 dhe Nenit 72 të LPP-së.

Përgjigje në Pretendimin ankimor nr. 2

OE ankues pajtohet me vendimin e AK-se lidhur me eliminimin e GOE “AC ING SH.P.K & A CON

SH.P.K”, sa i përket kërkesës 2 te Nenit 9.1&9.2 te FDT-së.

Lidhur me këtë pike eksperti shqyrtues ka dhënë përgjigje me lartë me numër rendor 1 dhe 2 tek shtjellimi i pretendimeve të GOE “AC ING SH.P.K & A CON SH.P.K”.

Përgjigje në Pretendimin ankimor nr. 4

OE ankues thotë se pajtohet me arsyet e eliminimit për GOE “ Edona SH.P.K; Suvatimi SH.P.K; Company Murseli SH.P.K”.

Lidhur me këtë pretendim eksperti shqyrtues ka dhënë mendimin e tij ne shqyrtimet e pretendimeve 1,2,3 të GOE-ve “Edona SH.P.K ;Suvatimi SH.P.K; Company Murseli SH.P.K”.Shih më lartë tabelën.

Përgjigje në Pretendimet ankimore nr. 3,5,6,7,8,9,10

OE ankues thotë se pajtohet me vendimin e AK-së në lidhje me GOE ARIANI CONSTRUCTION SH.P.K; ALPING SH.P.K; Eng group SH.P.K; Arch –Ndertimi SH.P.K;

Për GOE OLI-Hidroterm SH.P.K; FIDOLA SH.P.K. Për OE MERCOM Company SH.P.K; Për GOE NNP Standard SH.P.K; Arifaj SH.P.K; Për OE Krapa COM SH.P.K; Për OE IR Project, N.N.P.T Engineering ; N.N.P ART PROJEKT

Lidhur me këto pretendime për OE-të të lartcekur nga OE ankues, eksperti shqyrtues sqaron se në raportin e vlerësimit nga AK-ja, OE-të janë të pa përgjegjshëm dhe OE-të e lartë cekur nuk kanë paraqitur ankesë.

Përgjigje në Pretendimin ankimor nr. 11

OE ankues pajtohet me vendimin e AK-së sa i përket arsyes së eliminimit të OE OLTİ TRASİNG SH.P.K.

Lidhur me këtë pretendim eksperti shqyrtues ka dhënë sqarimet e tij më lartë: Shih më lartë pretendimin numër rendor 1 të OE OLTİ TRASİNG SH.P.K.

Mendimi i ekspertit shqyrtues/teknik

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE-ve ankues të aprovohen pjesërisht si të bazuara, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në **Rivlerësim**.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 16.10.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues me datë 19.10.2020 me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

From: Prokurimi Gjilan

Sent: Monday, October 19, 2020 8:43 AM

To: OSHP

Cc: Ardian Behra; Blerim Dina; Nuhi Paqarizi; Goran Milenkovic; Gjemajli Bellanica; Izet Kurteshi

**Subject:** F ë: 714 718 720 721/20 eksp

Te nderuar,

Ne lidhje me aktivitetin e prokurimit me titull: " Ndërtimi i ri i stacionit të autobusëve ", Ak- Komuna e Gjilanit nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues me nr ,714 718 720 721/20.

Andaj, presim nga Paneli Shqyrtues – OSHP, që në një afat sa më të afërt kohor të caktohet seanca kryesore dhe të njoftohet AK – me Vendimin e Panelit Shqyrtues.

Me respekt!

Departamenti i prokurimit

Komuna e Gjilanit

---

Operatori Ekonomik “Oltitrasing” SH.P.K- Prishtinë, nuk e ka njoftuar OSHP-në se a e mbështet mendimin e ekspertit shqyrtues .

Operatori Ekonomik: GOE “Edona” SH.P.K, “Company Murseli” SH.P.K “Suvatimi” SH.P.K nuk e ka njoftuar OSHP-në se a e mbështet mendimin e ekspertit shqyrtues .

Operatori Ekonomik “AC Ing” SH.P.K me datë 20.10.2020, me anë të parashtrësës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Organi Shqyrtues i Prokurimit

Adresa e AK: Rr. "MIGJENI" Ish Ndërtesa e Bankës së Lubjanës, Kati i V-të

Qyteti: PRISHTINË

Titulli: “Ndërtimi i ri i stacionit të autobusëve”

Numri i prokurimit: **651-20-2311-5-1-1**

Numri i brendshëm: **GL 651 20 021 511**

Nga: “AC ing”Sh.p.k & “A CON ” Sh.p.k

Adresa e AK: Qendra Tregtare Bregu i Diellit , Lok.Nr.47

Lënda: Përgjigjja e GOE



Pasi kemi pranua e-mail me datë:16.10.2020,ora 14;08 nga OSHP-ja ku ne e-mail është bashkangjitur raporti i ekspertit me numër 714 718 720 721/20 dhe është kërkuar të japim një përgjigje për këtë raport se pajtohemi apo nuk pajtohemi me mendimin e ekspertit.

Ne nuk pajtohemi me mendimin e ekspertit për arsye se ka dëshmi të mjaftueshme që eksperti të propozon të panelit shqyrtues i OSHP-së ne si GOE si i plotësojmë të gjitha kushtet në bazë të njoftimit për kontratë dhe në bazë të FDT-së .

Prandaj kërkojmë nga paneli shqyrtues i OSHP-së të nxjerr vendim të qartë ku ne të shpallemi fitues si GOE me çmime më të ultë dhe ta hudhë poshtë propozimin e ekspertit për rivlerësim.

“AC Ing”Sh.p.k            “A CON”Sh.p.k

Prishtinë-20.10.2020

Operatori Ekonomik, “A Con” SH.P.K – ,me datë: 20.10.2020, me anë të parashtrësës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk-pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Organi Shqyrtues i Prokurimit

Adresa e AK: Rr. "MIGJENI" Ish Ndërtesa e Bankës së Lubjanës, Kati i V-të

Qyteti: PRISHTINË

Titulli: “Ndërtimi i ri i stacionit të autobusëve”

Numri i prokurimit: 651-20-2311-5-1-1

Numri i brendshëm: GL 651 20 021 511

Nga: “AC ing”SH.P.K & “A CON ” SH.P.K

Adresa e AK: Qendra Tregtare Bregu i Diellit , Lok. Nr.47

Lënda: Përgjigja e GOE

Pasi kemi pranua e-mail me datë:16.10.2020,ora 14;08 nga OSHP-ja ku ne e-mail është bashkangjitur raporti i ekspertit me numër 714 718 720 721/20 dhe është kërkuar të japim një përgjigje për këtë raport se pajtohemi apo nuk pajtohemi me mendimin e ekspertit.

Ne nuk pajtohemi me mendimin e ekspertit për arsye se ka dëshmi të mjaftueshme që eksperti të propozon të panelit shqyrtues i OSHP-së ne si GOE si i plotësojmë të gjitha kushtet në bazë të njoftimit për kontratë dhe në bazë të FDT-së .

Prandaj kërkojmë nga paneli shqyrtues i OSHP-së të nxjerr vendim të qartë ku ne të shpallemi fitues si GOE me çmime më të ultë dhe ta hudhë poshtë propozimin e ekspertit për rivlerësim.

“AC Ing”Sh.p.k            “A CON”Sh.p.k

Prishtinë-20.10.2020

Operatori Ekonomik “BM Grup” SH.P.K me datë: 19.10.2020, me anë të parashtrësës ka njoftuar OSHP-

në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 28.10.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesat e operatorëve ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Oltitrasing" SH.P.K, se nuk qëndron arsyeja e eliminimit nga ana e AK-së, ku thotë se ju mungon validiteti i certifikatave për saldator sepse të katër salduesit e paraqitur, certifikatat kanë validitet 3 vjeçar mirëpo duhet që për çdo vit të bëhet ri lëshimi i certifikatave, po ashtu nuk ka as kontrata pune, CV apo ndonjë referencë.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është: "Operatori ekonomike duhet të angazhoj personelin profesional te cilët duhet te kenë kualifikimet shkollore te mëposhtme..... 4 ( Katër ) saldues të certifikuar" Dhe si dëshmi dokumentare është kërkuar: "Për te gjithë personelin profesional - Për menaxherin e Projektit si dhe Personelin Kryesor Teknik, të paraqiten Diplomat përkatëse te noterizuar , kontratat e punës , CV dhe letër referencë në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësit. Një ashtu për salduesit kopja e certifikatës"

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE ankues ka ofruar një listë me katër saldues konform dosjes së tenderit dhe për këta saldues si dëshmi ka paraqitur kontrata të punës me kohë të caktuar, CV, referencë dhe Certifikatat valide të noterizuar. Ndërsa, sa i përket arsyes së AK-së që certifikatat duhet të ri lëshohen çdo vit, Paneli Shqyrtues konform eksperti shqyrtues vlerëson se certifikatat janë valide dhe janë konform kërkesës së dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontratë. Andaj, ky pretendim ankimor është i qëndrueshëm.

Sa i përket pretendimit të grupit të operatorëve ekonomik "Edona" SH.P.K"; "Company Murseli" SH.P.K" "Suvatimi" SH.P.K, se AK e ka eliminuar për shkak se nuk e ka dorëzuar listën e kontratave sipas Aneksit 6 të dosjes së tenderit. OE ankues pretendon qe kjo arsye është e pa qëndrueshme për shkak se lista e paraqitur nga ana e OE nuk dallon në substancë nga lista të cilën e ka kërkuar AK.

Paneli Shqyrtues konform eksperti shqyrtues sqaron se kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është: "Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses se paku 2 kontrata te ngjashme në 3 ( tri ) vitet e fundit ( duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë. vlera,

minimale duhet të jetë – 600 000,00 €”. Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: “Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës të bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve”.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se si dëshmi, OE ankues ka paraqitur listën e projekteve të realizuara e cila nuk është e njëjtë me formën e tabelës së paraqitur në Aneksin 6 të dosjes së tenderit, por lista i përmban të dhënat lidhur me projektet e kërkuara, autoritetin kontraktues, vlerën e projektit, operatorin ekonomik si dhe vitin. Po ashtu, OE ka bashkëngjitur kontratat dhe referencat konform dosjes së tenderit. Andaj, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i qëndrueshëm. Në qoftë se AK ka ndonjë paqartësi sa u përket kontratave të realizuara, referencat ose për certifikata, AK gjatë rivlerësimit mund të kërkoj sqarime konform nenit 59.2 dhe nenit 72 të LPP-së.

Lidhur me pretendimin e dytë të grupit të operatorëve ekonomik “Edona” SH.P.K”; “Company Murseli” SH.P.K” Suvatimi” SH.P.K.;, se për menaxher të projektit ka caktuar z. Elnaim Ymeri, ku ky inxhinier ka kontratë me KK Gjilan në projektin hartimin e projekteve në infrastrukturën rrugore. OE ankues pretendon që kjo arsye nuk qëndron për faktin se nuk ka asnjë dëshmi se i njëjti inxhinier ka marr pjesë në hartimin e projekteve konkretisht për tenderin “Ndërtimi i ri stacionit të autobusëve”.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se eksperti shqyrtues me datën 08.10.2020 i ka dërguar letër AK-së përmes postës elektronike, ku ka kërkuar dëshmi lidhur me inxhinierin z. Elnaim Ymeri dhe ka kërkuar më shumë sqarime. Deri në momentin e hartimit të ekspertizës AK-ja nuk është përgjigjur postës elektronike. z. Elnaim Ymeri figuron në listën e të punësuarve të kompanisë “Edona” SH.P.K dhe në CV e tij të ofruar ka cekur që ka mbikëqyr disa projekte në Komunën e Gjilanit mirëpo për projektin në fjalë nuk ka të dhëna. Andaj, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson që AK gjatë rivlerësimit mund të sqaroj këtë pikë konform dispozitave të LPP-së.

Lidhur me arsyen e tretë të eliminimit të grupit të operatorëve ekonomik “Edona” SH.P.K”; “Company Murseli” SH.P.K” Suvatimi” SH.P.K.;, se nuk e ka dorëzuar listën e pagave për 20 (njëzetë punëtor). OE ankues pretendon që kjo arsye e eliminimit është e pa qëndrueshme për faktin se OE ka prezantuar listën e pagave për 20 punëtorë ashtu siç është kërkuar në FDT dhe kemi bashkëngjitur edhe listën e pagave nga ATK-ja.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është: “Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar min. 20 punëtor ”Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: “Listën e pagave të operatorit ekonomik. Duhet të dorëzohet origjinal ose

kopje e noterizuar”.

Lidhur me këtë pretendim ankimor, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE ankues si dëshmi dokumentare ka paraqitur listë të punëtorëve ndërsa në dosje të tenderit decidivisht është kërkuar listë e pagave për 20 punëtorë, andaj dëshmitë e ofruara nga OE nuk janë konform dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Ndërsa, sa i përket pretendimit se OE ankues ka bashkangjitur edhe listën e ATK-së, në ofertën e OE ankues nuk gjendet listë të ATK-së. Andaj, ky pretendim ankimor në këtë pikë është i pa bazuar.

Në lidhje me pretendimin e grupit të operatorëve ekonomik “AC Ing “SH.P.K & “A CON” SH.P.K, ku pretendon se arsyet e eliminimit nga AK janë të pabazuara sepse salduesve i mungojnë: Kontratat, CV dhe referencat e salduesve nuk ka qenë kërkesë e FDT-së për dorëzim.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontratë është: “Operatori ekonomike duhet te angazhoj personelin profesional te cilët duhet te kenë kualifikimet shkollore te mëposhtme ....4 ( Katër ) saldues të certifikuar” Dhe si dëshmi dokumentare është kërkuar: “Për te gjithë personelin profesional - Për menaxherin e Projektit si dhe Personelin Kryesor Teknik, të paraqiten Diplomat përkatëse te noterizuar, kontratat e punës, CV dhe letër referencë në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësit. Një ashtu për salduesit kopja e certifikatës”.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE ankues nuk ka paraqitur kontratë pune, CV, referenca për saldues me arsyetimin q ë nuk janë kërkuar në FDT. Mirëpo, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se edhe për saldues janë kërkuar kontrata e punës, CV, referenca. Më lartë janë prezantuar kërkesat dhe dëshmitë e kërkuara në FDT. Andaj, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson që dëshmitë e ofruara nuk e plotësojnë tërësisht dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë, rrjedhimisht ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Sa i përket arsyes së dytë të eliminimit të grupit të operatorëve ekonomik “AC Ing “SH.P.K & “A CON” SH.P.K, ku pretendon që arsyeja e eliminimit Kontratat, CV dhe referencat e salduesve është e pa bazuar sepse salduesi z.Artan Dashi posedon Certifikatë me Nr: i Certifikatës është ER-414-QT Ë.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se eksperti ka bërë verifikimin e certifikatës të z.Artan Dashi të prezantuar me numër ER-414-QT Ë dhe rezulton që certifikata është valide dhe vlen prej 08.11.2018 deri me 07.11.2021. Andaj, ky pretendim ankimor është i bazuar.

Në lidhje me pretendimin e OE ankues BM Grup SH.P.K, se AK e ka eliminuar me arsyetimin se nuk e ka plotësuar kërkesën numër 3 të nenin 9.1 & 9.2 te dosjes se tenderit, për skelet mbajtëse.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është: “Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te

domosdoshme për realizimin e projektit Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT-se” Dhe si dëshmi dokumentare është kërkuar: “OE duhet te plotësoj dhe dorëzoj listën e pajisjeve duke plotësuar Aneksin 7 te Dosjes se Tenderit dhe duhet te bashkëngjis Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet qe nuk regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit për automjetet qe regjistrohen. Ne rastet kur OE ka marrëveshje për shfrytëzimin, OE duhet te dorëzoj edhe marrëveshjen për shfrytëzim”

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE ankues ka paraqitur një marrëveshje për qiramarrje me OE Timo Construction SH.P.K, për plotësimin e Aneksit 7 t ë dosjes se tenderit. Andaj, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se ky pretendim ankimor është i bazuar, mirëpo në rast se AK-ja ka paqartësi gjatë rivlerësimit mund të kërkoj sqarime konform nenit 59.2 dhe nenit 72 t ë LPP-së.

Sa i përket pretendimit të dytë të OE ankues BM Grup SH.P.K, se OE ankues pajtohet me vendimin e AK-se lidhur me eliminimin e GOE “AC ING SH.P.K & A CON SH.P.K”, sa i përket kërkesës 2 te Nenit 9.1&9.2 te FDT-së.

Lidhur me këtë pik ë, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues ka dhënë përgjigje më lartë me numër rendor 1 dhe 2 tek shtjellimi i pretendimeve të GOE “AC ING SH.P.K & A CON SH.P.K”.

Në lidhje me pretendimin e katër të OE ankues BM Grup SH.P.K, se pajtohet me arsyet e eliminimit për GOE “ Edona SH.P.K; Suvatimi SH.P.K; Company Murseli SH.P.K”.

Lidhur me këtë pretendim, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se janë dhënë konstatimet në shqyrtimet e pretendimeve të grupit të operatorëve ekonomik “Edona SH.P.K ;Suvatimi SH.P.K; Company Murseli SH.P.K”.

Sa i përket pretendimeve ankimore nr. 3,5,6,7,8,9,10 t ë OE ankues BM Grup SH.P.K, se pajtohet me vendimin e AK-së në lidhje me grupin e operatorëve ekonomik ARIANI CONSTRUCKTION SH.P.K; ALPING SH.P.K; Eng group SH.P.K; Arch –Ndertimi SH.P.K; për GOE OLI-Hidroterm SH.P.K; FIDOLA SH.P.K. Për OE MERCOM Company SH.P.K; për GOE NNP Standard SH.P.K; Arifaj SH.P.K; Për OE Krap COM SH.P.K; për OE IR Project, N.N.P.T Engineering ; N.N.P ART PROJEKT.

Lidhur me këto pretendime për OE-të të lartcekur nga OE ankues, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në raportin e vlerësimit nga AK-ja, OE-të janë të pa përgjegjshëm dhe OE-të e lartë cekur nuk kanë paraqitur ankesë.

Në lidhje me pretendimin e fundit të OE ankues BM Grup SH.P.K, se pajtohet me vendimin e AK-së sa i

përket arsyes së eliminimit të OE OLTI TRASING SH.P.K.

Lidhur me këtë pretendim, Paneli Shqyrtues sqaron se ka dhënë përgjigje më lartë për këtë pretendim.

Paneli Shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës dhe sqarimet e ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues nuk ka bërë ekzaminimin, krahasimin dhe vlerësimin e tenderëve në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit dhe nenit 59 të LPP-së. Andaj, obligohet AK që të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, si dhe të bëjë vlerësimin dhe ekzaminimin e tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues  
  
Blerim Dina

#### **Vendimi t'i dorëzohet:**

- 1x1 AK "KK-Komunal" (KK-GJ);
- 1x1 OE "Oltitrasing" SH.P.K- Prishtinë;
- 1x1 OE "Edona" SH.P.K, "Company Murseli" SH.P.K, "Suvatimi" SH.P.K";
- 1x1 OE "AC Ing" SH.P.K-, OE: "A Con"SH.P.K-,
- 1x1 OE "BM Grup" SH.P.K,
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.